



Në përputhje me nenin 8-v të Kodit zgjedhor, pjesëmarrësit në zgjedhjet për anëtarë të këshillit të komunës së Tetovës, caktuar më datë 20 gusht 2022, nënshkruajnë këtë

KOD PËR ZGJEDHJE KORREKTE DHE DEMOKRATIKE

Zgjedhje, të cilat janë korrekte dhe demokratike dhe që i respektojnë parimet e demokracisë dhe sundimit të mire, kontribuojnë për zhvillimin demokratik të shoqërisë. Të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhje, me aktivitetet e tyre e marrin pjesë nëpërfundimin e vlerave fundamentale të demokracisë dhe kontribuojnë për ndërtimin e besimit në sistemin zgjedhor.

Informacioni se bashkërisht marrim pjesë në procesin e mbajtjes së nivelit të lartë të demokracisë, për ne pjesëmarrësit në zgjedhje për anëtarë të këshillit të komunës së Tetovës, të caktuara më datë 20 gusht 2022, është i rëndësishëm së paçmueshme.

Pikërisht për këtë, u dakorduar dhe e nënshkruajmë këtë Kod për zgjedhje korrekte dhe demokratike. Në mënyrë solemne, obligohemi dhe betohemi ndërmjet nesh, por edhe para të gjithë qytetarëve, se do t'i përmbahemi dhe në mënyrë aktive do ta promovojmë këtë Kod.

Ne, pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, obligohemi se do t'i respektojmë të gjithë ligjet, rregullat dhe dispozitat të cilat janë relevante për zgjedhjet dhe do ta respektojmë sundimin e së drejtës gjatë organizimit dhe zbatimit të zgjedhjeve.

Ne, pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, pa mëdyshje obligohemi se nuk do të kryejmë asnjë lloj presioni ose përpjekje ndaj të punësuarve në administratën publike dhe shtetërore, në institucionet e tjera ose entet e financuara nga Buxheti i shtetit, buxheti i komunave dhe i Qytetit të Shkupit, si dhe shoqërive tregtare dhe ndërmarrjeve me kapital shtetëror.

Ne, pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, obligohemi se nuk do të përdorim gjuhë të urrejtjes dhe nuk do të kryejmë diskriminim në bazë të gjinisë.

Ne, pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, gjithashtu, pa mëdyshje obligohemi se asnjë person i punësuar ose qytetar nuk do të jetë subjekt i çfarëdo lloj kërcënimi në raport me punësimin e tij dhe sigurinë sociale si rezultat i mbështetjes ose mosmbështetjes së tij për cilën do prej partive politike ose kandidati.

Abdulla Usmani Usmani

(Emri dhe mbiemri, Bartësi i listës)